



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 938
 Datë: 27/06/2024

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË
 DIPLOMËS MASTER**

FAKULTETI	Fakulteti i Inzhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Termoenergjetikë dhe energji e Ripërtërishme
Titulli i punimit	“ANALIZË E BILANCIT ENERGJETIK NË OBJEKTIN SHFMU “MODEL”- PEJË”
Kandidati	Bsc. Besart Zeqiraj
Mentori	Mentori: Prof. Assoc. Dr. Bedri Dragusha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshilin e Fakultetit	Datë: 03/07/2023 Vendimi Nr.: 1149
<p>Vlerësimi i dorëshkrimit.</p> <p>Në bazë të vendimit të Dekanit të Fakultetit, Nr. 1149 të datës 03/07/2023 është formuar komisioni me këtë përbërje :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prof. Dr. Xhevat Berisha, kryetar 2. Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha, mentor 3. Prof. Dr. Drenusha Krasniqi, anëtar <p>Për vlerësimin e punimit Master me titull “ANALIZË E BILANCIT ENERGJETIK NË OBJEKTIN SHFMU “MODEL”- PEJË” të kandidatit Bsc. Besart Zeqiraj.</p> <p>Pas kontrollimit të punimit të lartpërmendur Komisioni jep këtë:</p> <p style="text-align: center;">RAPORT</p> <p>Punimi me titull “ANALIZË E BILANCIT ENERGJETIK NË OBJEKTIN SHFMU “MODEL”- PEJË” është hartuar në 7 kapituj dhe është ilustruar përmes 15 figurave, 27 tabelave dhe 15 formulave.</p> <p>Në kapitullin e parë është pasqyruar një përmbledhje rreth historisë dhe klasifikimeve të energjisë në formën e përgjithshme.</p> <p>Në kapitullin e dytë është pasqyruar dhe janë shtjelluar faktorët dhe elementet të cilët ndikojnë në Bilancin Energjetik të Objektit.</p> <p>Në kapitullin e tretë janë llogaritur humbjet e nxehtësisë, duke filluar nga llogaritja e koeficienteve të humbjeve të nxehtësisë të mureve të jashtme, mureve të brendshme, tavanit, dyshemesë, pllaka mes kateve.</p>	

Formulari – F3

Në kapitullin e katërt është bërë përzgjedhja e trupave ngrohës duke filluar nga kati përdhësë, kati i parë, kati i dytë, ngrohja në dysHEME, llogaritja e rrjetit gypor dhe pompave, përzgjedhja e kalldave, enës së zgjerimit dhe të gjitha elementeve të tjera për funksionalizimin e ngrohjes qendrore.

Në kapitullin e pestë është pasqyruar një përmbledhje rreth pajisjeve të ngrohjes-ftohjes CHILLER, rreth klasifikimit të chillereve, aplikimit të chillereve, konfigurimeve të sistemeve si dhe përparimet dhe tendencat e fundit rreth chillerve.

Në kapitullin e gjashtë janë dhënë përfundimet dhe rekomandimet e nevojshme për zëvendesimin e pajisjeve si CHILLER në vend të kalldasë me pelet.

Në kapitullin e shtatë është pasqyruar lista e literaturës së përdorur në këtë punim.

PËRFUNDIM

Në bazë të shqyrtimit të punimit Master, Komisioni për vlerësimin konsideron se punimi është hartuar në nivelin e duhur, e që është i shtjelluar përmes figurave, tabelave dhe formulave. Prandaj, Komisioni për vlerësimin e punimit Master, të kandidatit Bsc. Besart Zeqiraj me titull “ANALIZË E BILANCIT ENERGJETIK NË OBJEKTIN SHFMU “MODEL”- PEJË” konsideron se punimi i plotëson të gjitha kriteret për punim Master dhe propozon që të jepet në diskutim publik.

Prishtinë: 27/06/2024 Komisioni:

1. Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha

 - mentor

2. Prof. Dr. Xhevat Berisha

 - kryetar

3. Prof. ass. Dr. Drenusha Krasniqi

 - anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
TERMOENERGJETIKË DHE ENERGJI E RIPËRTËRITSHME



TEMË DIPLOME

“ANALIZË E BILANCIT ENERGJETIK NË OBJEKTIN SHFMU “MODEL”- PEJË”

Mentori: Prof. Assoc. Dr. Bedri Dragusha

Kandidati: BSc. Besart Zeqiraj

Prishtinë, 2024.

PËRMBLEDHJA (ABSTRAKT)

Menaxhimi efikas i burimeve të energjisë në objektet arsimore është një çështje e rëndësishme në epokën bashkëkohore, i nxitur nga imperativat e qëndrueshmërisë ekonomike dhe kujdesit mjedisor. Ky punim diplome paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të bilancit të energjisë termike brenda objektit të shkollës fillore SHFMU "Model" në Pejë, me fokus në kuptimin e ndërveprimit kompleks të faktorëve që ndikojnë në shfrytëzimin dhe efikasitetin e energjisë. Nëpërmjet një kombinimi të kornizave teorike, mbledhjes së të dhënave empirike dhe teknikave të modelimit llogaritës, studimi kërkon të sqarojë dinamikën e transferimit të nxehtësisë brenda mjedisit fizik të shkollës. Në qendër të analizës është një ekzaminim gjithëpërfshirës i dizajnit të ndërtesës, materialeve të ndërtimit, vetive izoluese, sistemeve HVAC të cilat luajnë të gjitha role kryesore në formësimin e flukseve të energjisë termike. Duke përdorur parimet e termodinamikës dhe mekanikës së fluideve, kërkimi synon të përcaktojë sasinë dhe shpërndarjen e energjisë termike brenda ambienteve të shkollës në kushte të ndryshme klimatike. Kjo analizë është pasuruar më tej nga konsideratat e cilësisë së ajrit të brendshëm, komfortit termik dhe dinamikës socio-ekonomike që ndikon në modelet e kërkesës për energji. Gjetjet e studimit kanë implikime të rëndësishme si për kuptimin teorik ashtu edhe për zbatimin praktik në fushën e menaxhimit të energjisë së ndërtesave. Duke identifikuar fushat e joefikasitetit, mundësitë e mundshme të kursimit të energjisë dhe strategjitë për rritjen e rehatisë termike, kjo analizë kontribuon në zhvillimin e politikave dhe praktikave të bazuara në fakte që synojnë reduktimin e konsumit të energjisë dhe emetimeve të karbonit në institucionet arsimore. Për më tepër, njohuritë e nxjerra shërbejnë si një bazë për përpjekjet e ardhshme kërkimore në fushën më të gjerë të projektimit dhe funksionimit të qëndrueshëm të ndërtesave. Si përmbledhje, kjo temë paraqet një eksplorim rigoroz dhe ndërdisiplinor të dinamikës së energjisë termike në kuadër të shkollës fillore SHFMU "Model" në Pejë. Nëpërmjet sintezës së parimeve teorike, vëzhgimeve empirike dhe analizave llogaritëse, studimi ofron njohuri të vlefshme në ndërlikimet e menaxhimit të energjisë në mjediset arsimore.

Formulari – F3

Punimi ka këtë përmbajtje:

1. Hyrje
2. Bilanci energjetik i objektit
3. Humbjet e nxehtësisë
4. Përzgjedhja e trupave ngrohës
5. Aplikimi i chillerëve
6. Konkluzionet dhe Rekomandimet
7. Referencat